



Dep.		Nr. Prot.	
Dep.	DPK	S. Prot.	01/2345/13
Dep.		Prot. No.	
Nr. i tag.		Data	05.08.13
Sh. organica	/	Emri	
Nr. i prot.		Data	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së punës të Agjencisë kundër korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër korrupsionit me datë **05.08.2013**, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

***I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-1200/13 për z. Muhamet Latifi – Zavendës Ministër në Ministrinë e Forcës dhe Sigurisë së Kosovës, për shkak se është tejkalur situata e mundshme e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.***

**A r s y e t i m**

**I.** Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-1200-13, për Zyrtarin e lartë, z. Muhamet Latifi – ish Drejtor i Administratës së Shërbimit Civil, dhe njëkohësisht pjesë e strukturave drejtuese të Partisë Demokratike të Kosovës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Në rastin me numër protokoli AKK-03-1200/13, të hetuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari i lartë, z. Latifi së pari është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (Z.D.DPK-01-662/13), pas të cilës zyrtari i lartë ka kontaktuar Agjencinë kundër korrupsionit, me ç'rast pas kërkesës tonë na ka dërguar me shkrim njoftimin se ai tashmë ka ndrruar funksionin e tij dhe prej datës 04.07.2013 është emruar Zavendësministër i Forcës dhe Sigurisë në Qeverinë e Republikës së Kosovës. Vendimi Nr.260/2013, i zyrës së kryeministrit, i protokoluar në Agjenci me numër; DPK-03-2323/13.

Ztr. Latifi tani ka dhënë dorëheqje nga pozita e Drejtorit të Departamentit të Administratës së Shërbimit civil në Ministrinë e Administratës Publike, për të ushtruar funksionin e tij si i emruar politik në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Andaj, duke u bazuar në faktet dhe gjendjen reale, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtore i Agjencisë kundër korrupsionit

\_\_\_\_\_  
/ Hasan Preteni /

